VENDIM
Nr. 15, datë 3.4.2013

PËR RINOVIM LICENCE SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME BERAT–KUÇOVË
(Ndryshuar me VKM nr. 52, datë 14.12.2016)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 14 pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë", Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Rinovim licence për efekt të përfundimit të afatit operatorit sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Berat–Kuçovë, me:

- *Drejtues ligjor z. Refat Harizi*;
- *Drejtuesi teknik: z. Lulzim Sino*.

2. Operatori sh.a. UK Berat–Kuçovë autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:

- Kategoria A për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;
- Kategoria C për largimin e ujërave të ndotura.

3. Zona e mbulimit të këtij operatori është:

- Bashkitë: Berat, Kuçovë;
- Komunat: Vertop, Otllak, Perondi, Kozare.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare deri më 2.4.2017.

KRYETARI
Avni Dervishi